



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

akti 20 mbet  
dt 02.08.2024



VENDIM

Nr.14, datë 30.07.2024

PËR

**MIRATIMIN ME NDRYSHIM TË LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE, ME OSE PA UJË, TË SUBJEKTIT “GJOKA KONSTRUKSION” SH.P.K ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT ZALLI I BULQIZËS, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujqor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: Shtrati i Lumit Zalli i Bulqizës, Bashkia Bulqizë, Dibër, për zbatimin e projektit “Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerencit-Peshkopi (Peshkopi-Maqellarë), Loti 3”.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri burimit ujqor: Lumi Zalli i Bulqizës



Koordinatat e konturit të sheshit për shfrytëzim (KRGJSH):

Nr.	X	Y	Z	Nr.	X	Y	Z
1	535798	4600174	466	23	536697	4601536	452.10
2	536049	4600474	462.6	24	536614	4601561	453.30
3	536025	4600562	461.7	25	536554	4601507	454.00
4	536117	4600635	460.9	26	536525	4601417	454.10
5	536097	4600758	459.85	27	536527	4601263	454.70
6	536301	4601188	456.6	28	536515	4601173	455.05
7	536428	4601220	455.5	29	536526	4601069	455.50
8	536420	4601328	455.3	30	536488	4600976	456.50
9	536513	4601503	454.1	31	536451	4600982	456.70
10	536529	4601683	452.5	32	536430	4600965	457.05
11	536710	4601811	451.5	33	536340	4600833	458.05
12	536732	4601887	450.9	34	536332	4600785	459.10
13	536824	4601910	450.4	35	536313	4600739	459.10
14	536894	4602148	448.5	36	536287	4600594	459.20
15	536963	4602153	447.8	37	536229	4600534	460.00
16	536964	4602084	448.2	38	536189	4600535	460.50
17	536925	4602011	448.9	39	536133	4600502	461.10
18	536971	4601871	449.5	40	536094	4600465	461.00
19	536960	4601789	450.00	41	536035	4600239	462.50
20	536908	4601743	450.40	42	535891	4600180	464.50
21	536840	4601618	450.90	43	535846	4600148	465.10
22	536797	4601567	451.20				

Koordinatat e pikës së depozitimit (KRGJSH)

Nr.	X	Y	Z
A	4452998	4601376	456.6
B	4453048	4601387	456.3
C	4453070	4601340	456.2
D	4453021	4601243	457.4
E	4452971	4601232	457.7
F	4452949	4601278	457.6

3. Sipërfaqja e taracës lumore që do të shfrytëzohet : 255 511 m<sup>2</sup>;
4. Volumi i materialit të kërkuar : 84 000 m<sup>3</sup>;

5. Subjekti të respektojë të gjitha sygjerimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSHja;
6. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU- Drin-Bunë për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
7. Të ndiqet nga ZABU- Drin-Bunë zbatimi i projektit të rehabilitimit;
8. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
9. Leja për shfrytëzimit të materialit inert jepet me kusht që të mos kufizohet nevojat e bujqësisë në zonë. (Ndryshim i propozuar nga KBU Drin-Bunë)
10. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

